



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETİ  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 786/24 Dt. 24.12.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu”, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**  
**Për lejimin e mjeteve**

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” në Prizren, për lejimin e mjeteve financiare për pagesën (honorarët) për të angazhuarit e jashtëm për shfaqjen teatrore “Teatri i Zërit”, të autorit dhe regjisoret Kaltrim Balaj, kështu që, në emër të pagesës së angazhimit, lejohen mjetet e nevojshme financiare për secilin prej të angazhuarave të jashtëm si në vijim për:
  - 1.1. Kaltrim Balaj,-autor dhe regjisori, lejohen mjetet në shumën prej 3000 € (tremijë euro),
  - 1.2. Onur Cibo-skenograf, lejohen mjetet në shumën prej 2500 € (dymijë e pesëqind euro),
  - 1.3. Doruntina Ukimeri- konstumografe dhe realizuese e kostumeve, lejohen mjetet në shumën prej 3000 € (tremijë euro),
  - 1.4. Gëzim Sertollaj-koreograf dhe trajner i ushtrimeve fizike, lejohen mjetet në shumën prej 2950 € (dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro),
  - 1.5. Abdulla Zogaj-realizues i skenografisë- lejohen mjetet në shumën prej 1800 € (njëmijë e tetëqind euro),
  - 1.6. Skender Latifi –dizajner i dritave dhe efekteve vizuale, lejohen mjetet në shumën prej 1850 € (njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë euro),
  - 1.7. Dardan Luta, dizajner i materialeve promovuese dhe shtypit, lejohen mjetet në shumën prej 1250 € (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë euro),
  - 1.8. Canan Güner-prostetik dhe make up artist, lejohen mjetet në shumën prej 2300 € (dymijë e treqind euro)
  - 1.9. Ender Shaljani-xhirues dhe fotograf i shfaqjes, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),
  - 1.10. Arshi Shaljani-PR, lejohen mjetet në shumën prej 800 € (tetëqind euro),

2. Shuma e përgjithshme që lejohet është 20.250 € (njëzetmijë e dyqind e pesëdhjetë euro).
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohen nga buxheti i Komunës pozicioni i subvencioneve dhe transfereve -kodi nga Teatri i Qytetit (nr. 85157).
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Teatri i Qytetit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
  - Teatrit të Qytetit,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.